



# FLETORJA ZYRTARE

## E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 61

2002

Tetor

### P Ë R M B A J T J A

|                                |                                                                                                                                                                       | Faqe |
|--------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Ligj nr.8936<br>datë 12.9.2002 | Për një shtesë në ligjin nr.8770, datë 19.4.2001 “Për<br>shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike”<br>.....                                                           | 1705 |
| Ligj nr.8937<br>datë 12.9.2002 | Për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa<br>.....                                                                                                                        | 1705 |
| Ligj nr.8938<br>datë 12.9.2002 | Për ratifikimin e “Konventës nr.176 “Sigurimi dhe<br>shëndeti në miniera, 1995” të Organizatës<br>Ndërkombëtare të<br>Punës”.....                                     | 1706 |
| Ligj nr.8939<br>datë 12.9.2002 | Për ratifikimin e “Konventës nr.175 “Puna me kohë të<br>pjeshme, 1994” të Organizatës Ndërkombëtare të<br>Punës”.....<br>.....                                        | 1714 |
| Ligj nr.8940<br>datë 12.9.2002 | Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së<br>Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës<br>të Bullgarisë për shërbimet ajrore ndërmjet dhe përtej | 1719 |

tyre

**L I G J**  
**Nr. 8936, datë 12.9.2002**

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 8770, DATË 19.4.2001**  
**“PËR SHËRBIMIN E RUAJTJES DHE SIGURISË FIZIKE”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

Neni 1

Në ligjin nr.8770, datë 19.4.2001 “Për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike”, në nenin 14 pika 1 shkronja “c”, pas fjalës “policor” shtohen fjalët “ose ushtarak.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3483, datë 7.10.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,**  
**Alfred Moisiu**

**L I G J**  
**Nr. 8937, datë 12.9.2002**

**PËR RUAJTJEN E NXEHTËSISË NË NDËRTESA**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

Neni 1

Ky ligj ka për qëllim të krijojë bazën ligjore të nevojshme për vendosjen e rregullave dhe bërjen të detyrueshme të marrjes së masave për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa.

Neni 2

Për qëllimet e këtij ligji, termat e përdorura kanë këto kuptime:

“Ndërtesë” do të thotë një ngrehinë, një bashkësi lokalesh, mjedis banimi, shërbimi e prodhimi me karakter publik ose privat.

“Instalim termik” do të thotë bashkësi pajisjesh termike së bashku me rrjetin lidhës, që shërbejnë për ngrohjen dhe ftohjen e mjedisit të brendshëm të ndërtesave.

“Ngrohje qendrore” do të thotë një impiant ngrohjeje, që furnizon me energji termike një ose më shumë apartamente.

“Ngrohje lokale” do të thotë një impiant ngrohjeje, që furnizon me energji termike një grup ndërtesash të ndara nga njëra-tjetra.

#### Neni 3

Projektimi dhe ndërtimi i ndërtesave të realizojë parametrat teknikë të nevojshëm për ruajtjen, kursimin dhe përdorimin me efikasitet të energjisë. Të gjitha ndërtesat që do të ndërtohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të respektojnë koeficientin vëllimor e normativ të humbjeve termike (Gv), si dhe të parashikojnë vendosjen e instalimit termik të ngrohjes qendrore ose vendore.

#### Neni 4

Instalimet e prodhimit të nxehtësisë (gjeneratorët e nxehtësisë ose/dhe pompat e nxehtësisë) për ngrohjen dhe/ose freskimin e ndërtesave projektohen për arritjen e temperaturës së ajrit të brendshëm, sipas normave të komfortit të temperaturës, duke marrë parasysh kushtet klimatike zonale dhe anën funksionale të ndërtesës.

#### Neni 5

Këshilli i Ministrave përcakton normat, rregullat dhe kushtet e projektimit dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

#### Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3484, datë 7.10.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Alfred Moisiu**

### **L I G J** **Nr. 8938, datë 12.9.2002**

#### **PËR RATIFIKIMIN E “KONVENTËS NR.176 “SIGURIMI DHE SHËNDETI NË MINIERA, 1995” TË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

### **K U V E N D I**

#### **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË** **V E N D O S I :**

#### Neni 1

Ratifikohet “Konventa nr.176 “Sigurimi dhe shëndeti në miniera, 1995” e Organizatës Ndërkombëtare të Punës”.

#### Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3486, datë 7.10.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,**

KONVENTA NR. 176  
KONVENTA LIDHUR ME SIGURINË DHE SHËNDETIN NË MINIERA

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, e thirrur në Gjenevë nga Këshilli Administrativ i Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe e mbledhur më 6 qershor 1995 në sesionin e saj të 82-të:

duke nënvizuar konventat dhe rekomandimet ndërkombëtare të rëndësishme, në veçanti konventa mbi heqjen e punës së detyruar, 1957; konventa dhe rekomandimi mbi mbrojtjen kundër rrezatimit, 1960; konventa dhe rekomandimi mbi mbrojtjen e makinerive, 1963; konventa dhe rekomandimi lidhur me pagesat në rast aksidentesh në punë dhe sëmundjesh profesionale, 1964; konventa dhe rekomandimi mbi moshën minimale (punë e nëndheshme), 1965; konventa mbi ekzaminimin mjekësor të adoleshentëve (punë e nëndheshme), 1965; konventa dhe rekomandimi mbi mjedisin e punës (ndotja e ajrit, zhurmat dhe vibrimet), 1977; konventa dhe rekomandimi mbi sigurinë dhe shëndetin e punonjësve, 1981; konventa dhe rekomandimi mbi shërbimet e shëndetit në punë, 1985; konventa dhe rekomandimi mbi amiantin, 1986; konventa dhe rekomandimi mbi sigurinë dhe shëndetin në ndërtim, 1988; konventa dhe rekomandimi mbi prodhimet kimike, 1990; si dhe konventa dhe rekomandimi mbi parandalimin e aksidenteve madhore industriale, 1993;

duke marrë në konsideratë nevojën dhe të drejtën që kanë punonjësit për të qenë të informuar, të formuar dhe të konsultuar në mënyrë efektive, si dhe për të marrë pjesë në përgatitjen dhe zbatimin e masave lidhur me sigurinë dhe shëndetin përsa u përket rreziqeve ndaj të cilëve ata janë të ekspozuar në industrinë e minierave;

duke pranuar se është e dëshirueshme të parandalohet çdo aksident vdekjeprurës, dëmtim apo prekje të shëndetit, që mund të pësojnë punonjësit apo popullata, si dhe dëmtimet e ambientit, që mund të rezultojnë nga shfrytëzimi i minierave;

duke pasur parasysh nevojën e një bashkëpunimi ndërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Punës, Organizatës Botërore të Shëndetit, Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike dhe institucioneve të tjera kompetente dhe duke shënuar instrumentet, përmbledhjet e direktivave praktike, kodet dhe direktivat e rëndësishme të botuara nga këto organizata;

pasi u vendos të miratohen propozimet e ndryshme lidhur me sigurinë dhe shëndetin në miniera, çështje që përbën pikën e katërt të rendit të ditës të sesionit;

pasi u vendos që këto propozime të marrin formën e një konvente ndërkombëtare,

Miraton ditën e 22 qershorit 1995, konventën e mëposhtme, e cila do të quhet Konventa mbi sigurinë dhe shëndetin në miniera, 1995.

PJESA I  
PËRKUFIZIME

Neni 1

1. Për qëllimet e kësaj Konvente, termi “minierë” kupton:

a) çdo vend (qendër) në qiell të hapur ose nëntokësor, ku zhvillohen aktivitetet e mëposhtme:

(i) eksplorim i mineraleve, me përjashtim të naftës dhe të gazit, të cilët kërkojnë një ndryshim mekanik të terrenit;

(ii) nxjerrjen e mineraleve, me përjashtim të naftës dhe gazit;

(iii) përgatitjen e materialeve nxjerrëse, si thyerja, bluarsja, përqëndrimi ose larja;

b) tërësia e makinerive, pajisjet, aksesorët, instalimet, ndërtesat dhe strukturat e xhenios civile, të përdorura në raport me aktivitetet e përcaktuara në paragrafin a) si më sipër.

2. Për qëllimet e kësaj Konvente, termi “punëdhënës” tregon çdo person fizik apo juridik, që punëson një ose më shumë punonjës në një minierë, si dhe, nëse konteksti e implikon, shfrytëzues, ndërmarrësi kryesor, ndërmarrës ose nënkontraktues.

## PJESA II FUSHA DHE MODALITETET E APLIKIMIT

### Neni 2

1. Kjo Konventë është e zbatueshme për të gjitha minierat.
2. Pas konsultimesh me organizatat më të përfaqësuara të punëdhënësve dhe punëmarrësve të interesuar, organi kompetent i një Anëtar i cili ratifikon Konventën:
  - a) mund të përjashtojë disa kategori minierash nga zbatimi i Konventës ose nga disa dispozita të saj nëse, në tërësinë e saj, mbrojtja e akorduar sipas legjislacionit dhe praktikës kombëtare nuk është inferiore (më e pakët) se ajo që do të rezultonte nga aplikimi i plotë i dispozitave të Konventës;
  - b) duhet, në rastin ku disa kategori minierash janë objekt përjashtimi, sipas paragrafit a) si më sipër, të hartohen plane, me qëllim që të mbulohet në mënyrë progresive tërësia e minierave.
3. Çdo Anëtar që ratifikon këtë Konventë dhe që përfiton nga mundësia që jepet në paragrafin 2 a) si më sipër duhet të përcaktojë, në raportet mbi zbatimin e Konventës të paraqitura sipas nenit 22 të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, çdo kategori të veçantë minierash, e cila është objekt i një përjashtimi dhe arsytet e këtij përjashtimi.

### Neni 3

Anëtar i duhet, duke pasur parasysh konditat dhe praktikën kombëtare, dhe pas konsultimesh me organizatat më të përfaqësuara të punëdhënësve dhe punëmarrësve të interesuar, të formulojë dhe të zbatojë një politikë koherente në fushën e sigurisë dhe të shëndetit në miniera dhe ta rishikojë atë periodikisht, pikërisht lidhur me masat që u japin fuqi dispozitave të Konventës.

### Neni 4

1. Masat që synojnë të sigurojnë zbatimin e Konventës duhet të jenë të parashikuara nga legjislacioni kombëtar.
2. Kur të paraqitet nevoja, ky legjislacion duhet të plotësohet me:
  - a) norma teknike, parime kryesore, përmbledhje e direktiva praktike; ose
  - b) me mjete të tjera të zbatimit, në përputhje me praktikën kombëtare, të cilat do të identifikohen (përcaktohen) nga organi kompetent.

### Neni 5

1. Legjislacioni kombëtar i përmendur në nenin 4 paragrafi 1 duhet të caktojë organin që do të mbikëqyrë dhe rregullojë aspektet e ndryshme të sigurisë dhe shëndetit në miniera.
2. Ky legjislacion duhet të parashikojë:
  - a) mbikëqyrjen e sigurisë dhe shëndetit në miniera;
  - b) inspektimin e minierave nga inspektorë të caktuar për këtë qëllim nga organi kompetent;
  - c) procedurat e njoftimit dhe anketimit në rast aksidentesh vdekjeprurëse apo të rënda, si dhe katastrofash në miniera dhe incidentesh të rrezikshme, të tilla siç janë përcaktuar prej këtij legjislacioni;
  - d) përpilimi dhe publikimi i statistikave mbi rastet e aksidenteve, të sëmundjeve profesionale dhe incidenteve të rrezikshme, të tilla siç janë përcaktuar në këtë legjislacion;
  - e) pushteti (fuqia) e organit kompetent për të pezulluar ose kufizuar, për motive të sigurisë dhe shëndetit, veprimtaritë e minierave derisa kushtet që janë në origjinë të pezullimit apo kufizimit, të jenë korrigjuar;
  - f) hartimi i procedurave efikase me qëllim që t'u japë fuqi të drejtave të punonjësve dhe përfaqësuesve të tyre që të konsultohen për çështjet dhe të marrin pjesë në masat lidhur me sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës.
3. Ky legjislacion kombëtar duhet të parashikojë që fabrikimi, transporti dhe përdorimi i eksplozivëve dhe i detonatorëve në miniera duhet të kryhen nga persona kompetentë dhe të autorizuar ose nën mbikëqyrjen e tyre të drejtpërdrejtë.

4. Ky legjislacion duhet të parashtrijë:

a) masat që duhen ndjekur në fushën e shpëtimit në miniera, të ndihmës së parë, si dhe shërbimet e duhura mjeksore;

b) detyrimin për të furnizuar me aparate frymëmarrjeje shpëtimi individuale të përshtatshme për punonjësit në minierat e nëndheshme të gymyrit dhe nëse është e nevojshme, në miniera të tjera të nëndheshme, si dhe t'i mirëmbajë këto aparate;

c) masat mbrojtëse që zbatohen në punimet miniera të braktisura me qëllim, që të eliminohen ose të zvogëlohen në minimum rreziqet për sigurinë dhe shëndetin;

d) masat që synojnë të sigurojnë, në kushtet e një sigurie të kënaqshme, stokun, transportin dhe eliminimin e substancave të rrezikshme të përdorura në punimet në miniera, si dhe mbeturinat e prodhuara në minierë;

e) në rast nevojë, detyrimin të furnizojë dhe të mbajë në një gjendje higjienë të kënaqshme një numër të mjaftueshëm pajisjesh sanitare dhe instalimesh për t'u larë, ndërruar dhe ushqyer.

5. Ky legjislacion kombëtar duhet të parashikojë se punëdhënësi përgjegjës i minierës duhet të kujdeset për hartimin e planeve të përshtatshme për punimet në minierë para fillimit të operacioneve, si dhe gjatë gjithë modifikimit, si dhe rishikimin periodik të këtyre planeve, të cilët duhet të mbahen në dispozicion në qendrën e minierës.

### PJESA E III

### MASAT E PARANDALIMIT DHE TË MBROJTJES NË MINIERA

#### A. PËRGJEGJËSITË E PUNËDHËNËSVE

##### Neni 6

Duke marrë masat e parandalimit dhe të mbrojtjes të parashikuara nga kjo pjesë e Konventës, punëdhënësi duhet të vlerësojë rreziqet dhe t'i trajtojë ato sipas një renditjeje prioritare, si më poshtë:

a) eliminimi i këtyre rreziqeve;

b) të kontrollohen qysh në burim;

c) të zvogëlohen në minimum me mjete të ndryshme hartimi i metodave të tyre të punës të jenë të sigurtë;

d) në masën që këto rreziqe mbijetojnë, të parashikohet përdorimi i pajisjeve të mbrojtjes individuale;

duke patur parasysh atë çka është e arsyeshme, praktike, e realizueshme, si dhe atë që konsiderohet si një praktikë e mirë dhe në përputhje me shpejtësinë e kërkuar.

##### Neni 7

Punëdhënësi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të eliminuar ose zvogëluar në minimum rreziqet për sigurinë dhe shëndetin që paraqesin minierat nën autoritetin e tij dhe veçanërisht:

a) të kujdeset që miniera të konceptohet, ndërtohet dhe të ketë një pajisje elektrike, mekanike dhe tjetër, duke përfshirë një sistem komunikimi, në mënyrë që kushtet e nevojshme të sigurisë së shfrytëzimit, si dhe një mjedis i shëndetshëm pune të jenë të siguruara;

b) të kujdeset që miniera të vihet në shërbim, të shfrytëzohet, mirëmbahet dhe të deklarohet, në mënyrë të tillë që punonjësit të mund të kryejnë detyrat e caktuara pa rrezik për sigurinë dhe shëndetin e tyre ose të personave të tjerë;

c) të marrë masa për të ruajtur stabilitetin e terrenit në zonat në të cilat personat kanë akses për shkak të punës së tyre;

d) sa herë që kjo është e realizueshme, të parashikohen, duke u nisur për çdo vend pune të nëndheshëm, dy dalje, që dalin në rrugë të ndara që të çojnë jashtë;

e) të sigurojë kontrollin, vlerësimin dhe inspektimin periodik të mjedisit të punës, me qëllim që të identifikohen rreziqet e ndryshme ndaj të cilave punonjësit mund të jenë të ekspozuar dhe të vlerësojë shkallën e këtij ekspozimi;

f) të sigurohet një ajrim i përshtatshëm i të gjitha punimeve të nëndheshme, për të cilat akses

është i autorizuar;

g) për zonat e ekspozuara ndaj rreziqeve të veçanta, të hartohet dhe të zbatohet një plan shfrytëzimi dhe procedura të natyrës që të garantojnë sigurinë e sistemit të punës dhe mbrojtjen e punonjësve;

h) të merren masat e duhura, në përputhje me tipin e minierës së shfrytëzuar që të parandalohen, të zbulohen dhe të luftohen shpërthimet dhe përhapja e zjarreve dhe shpërthimeve (eksplozioneve);

i) kur siguria dhe shëndeti i punonjësve kërcënohen rëndë, të bëhet ndërprerja e veprimtarive dhe evakuimi i punonjësve drejt vendeve të sigurta.

#### Neni 8

Punëdhënësi duhet, për çdo minierë, të përgatisë një plan veprimi specifik të urgjencës, me qëllim parballimin e katastrofave industriale dhe natyrore logjikisht të parashikueshme.

#### Neni 9

Kur punonjës janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të natyrës fizike, kimike apo biologjike, punëdhënësi ka për detyrë:

a) t'i mbajë punonjësit të informuar, në mënyrë të kuptueshme, mbi rreziqet që paraqet puna e tyre, mbi rreziqet e mundshme që ajo përmban për shëndetin e tyre dhe mbi masat parandaluese dhe mbrojtëse të zbatueshme;

b) të marrë masat e duhura, me qëllim që të eliminojë apo të zvogëlojë në minimum rreziqet që rezultojnë nga ky ekspozim;

c) kur mbrojtja e përshtatshme kundër rreziqeve për aksidente apo dëmtime të shëndetit, dhe pikërisht kundër ekspozimit ndaj kushteve të dëmshme, nuk mund të sigurohet me mjete të tjera, të jepen dhe mirëmbahen, pa shpenzime nga ana e punonjësve, veshje të përshtatshme për këto nevoja, si dhe pajisje dhe mjete mbrojtëse të përcaktuara nga legjislacioni kombëtar, dhe

d) t'u sigurojë punonjësve që kanë vuajtur nga dëmtime apo sëmundje në vendin e punës, kujdesjet e para, mjete adekuate transporti për t'u larguar nga vendi i punës, si dhe aksesin në shërbimet e duhura mjekësore.

#### Neni 10

Punëdhënësi duhet të kujdeset që:

a) punonjësit të marrin, pa shpenzuar, një formim dhe një rikualifikim, (riaftësim) adekuat, si dhe udhëzime të kuptueshme lidhur me sigurinë dhe shëndetin, si dhe me detyrat që u janë caktuar;

b) në përputhje me legjislacionin kombëtar, të ushtrohet një mbikëqyrje dhe një kontroll mbi çdo ekip me qëllim që në rast shfrytëzimi i minierës të zhvillohet në kushtet e sigurisë;

c) të ngrihet një sistem me qëllim që të mund të njihen me saktësi, në çdo moment emrat e të gjithë personave që ndodhen në fund, si dhe lokalizimi i tyre i mundshëm;

d) të gjitha aksidentet dhe incidentet e rrezikshme, të tilla siç janë përcaktuar nga legjislacioni kombëtar, të bëhen objekt i një ankete dhe të merren masat e duhura për t'i ndrequr ato; dhe

e) të hartohet një raport mbi aksidentet dhe incidentet e rrezikshme në përputhje me legjislacionin kombëtar për organin kompetent.

#### Neni 11

Punëdhënësi duhet të sigurohet se një mbikëqyrje mjekësore e rregullt mbi punonjësit e ekspozuar ndaj rreziqeve profesionale, për shkak të veprimtarive në minierë, të ushtrohet sipas parimeve të përgjithshme të mjekësisë së punës dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar.

#### Neni 12

Nëse dy ose më shumë punëdhënës zhvillojnë veprimtari në të njëjtën minierë, punëdhënësi

përgjegjës i minierës duhet të koordinojë ekzekutimin e të gjitha masave lidhur me sigurinë dhe shëndetin e punonjësve dhe të konsiderohet (mbahet) përgjegjës i parë për sigurimin e operacioneve pa përfshirë punëdhënësit individualë nga përgjegjësia e tyre, përsa i përket zbatimit të të gjitha masave lidhur me sigurinë dhe shëndetin e punonjësve të tyre.

## B. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PUNONJËSVE DHE TË DELEGUARVE TË TYRE

### Neni 13

1. Legjislacioni kombëtar i përmendur në nenin 4 duhet t'u njohë punonjësve të drejtën:
  - a) t'i njoftojnë punëdhënësit dhe organit kompetent aksidentet, incidentet e rrezikshme dhe rreziqet;
  - b) të kërkojnë dhe të arrijnë që të bëhen inspektime dhe anketa nga punëdhënësi dhe organi kompetent kur ekziston një motiv preokupimi, që ka të bëjë me sigurinë dhe shëndetin; dhe
  - c) të njohin rreziqet në vendin e punës që mund të dëmtojnë sigurinë dhe shëndetin e tyre dhe të informohen për to;
  - d) të marrin informacione që i ka punëdhënësi ose autoriteti kompetent lidhur me sigurinë dhe shëndetin e tyre;
  - e) të largohen (mënjahen) nga çdo vend në minierë kur ka motive të arsyeshme për të menduar se ekziston një situatë që paraqet një rrezik serioz për sigurinë dhe shëndetin e tyre; dhe
  - f) të zgjedhin kolektivisht delegatët në sigurinë dhe shëndetin.
2. Delegatët e punonjësve në sigurinë dhe në shëndetin të përmendur në paragrafin 1 f) si më sipër do të duhet t'u njihet, në përputhje me legjislacionin kombëtar, e drejta:
  - a) të përfaqësojnë punonjësit për çdo gjë që lidhet me sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës, duke përfshirë, sipas rastit, ushtrimin e të drejtave të përmendura në paragrafin 1 si më sipër;
  - b) - të marrin pjesë në inspektimet dhe anketat që zhvillohen nga punëdhënësi dhe organi kompetent në vendin e punës;
    - të procedojnë me mbikëqyrje dhe anketimet lidhur me sigurinë dhe shëndetin;
  - c) të thërrasin këshilltarë dhe ekspertë të pavarur;
  - d) të konsultohen në kohën e përshtatshme me punëdhënësit për çështje që lidhen me sigurinë dhe shëndetin, duke përfshirë politikat dhe procedurat në këtë fushë;
  - e) të konsultohen me organin kompetent; dhe
  - f) t'u njoftohen aksidentet dhe incidentet e rrezikshme që interesojnë sektorin për të cilin ata janë seleksionuar.
3. Procedurat lidhur me ushtrimin e të drejtave të parashikuara në paragrafët 1 dhe 2 si më sipër do të përcaktohen:
  - a) nga legjislacioni kombëtar, si dhe
  - b) nëpërmjet konsultimesh ndërmjet punëdhënësve dhe punëmarrësve dhe përfaqësuesve të tyre.
4. Legjislacioni kombëtar do të duhet të arrijë që të drejtat e parashikuara në paragrafët 1 dhe 2 si më sipër të mund të ushtrohen pa diskriminim dhe pa raprezalje.

### Neni 14

Legjislacioni kombëtar do të duhet të parashikojë që, sipas formimit të tyre, punonjësit t'i nënshtrohen detyrimit:

- a) për t'u përshtatur masave të parashikuara në fushën e sigurisë dhe të shëndetit;
- b) për t'u kujdesur në mënyrë të arsyeshme për sigurinë dhe shëndetin e vetvetes, si dhe të personave të tjerë që mund të preken nga veprimet e tyre apo nga mungesat e tyre në punë, përfshirë këtu duke përdorur me korrektesë mjetet, veshjet mbrojtëse dhe pajisjet të vëna në dispozicionin e tyre për këtë qëllim dhe duke u kujdesur për ato;
- c) për t'i njoftuar menjëherë superiorit të tyre direkt çdo situatë, që, sipas mendimit të tyre, mund të paraqesë rrezik për sigurinë ose për shëndetin e tyre apo sigurinë e shëndetin e personave të tjerë, situatë të cilën ata vetë nuk janë në gjendje ta përballojnë në mënyrë të përshtatshme;

d) për të bashkëpunuar me punëdhënësin, me qëllim që detyrimet dhe përgjegjësitë në ngarkim të këtij të fundit sipas Konventës të respektohen.

### C. BASHKËPUNIMI

#### Neni 15

Duhen, të merren masa, në përputhje me legjislacionin kombëtar, për të inkurajuar bashkëpunimin ndërmjet punëdhënësve dhe punonjësve dhe përfaqësuesve të tyre, me qëllim promovimin e sigurisë dhe shëndetit në miniera.

### PJESA IV ZBATIMI

#### Neni 16

Anëtari do të duhet:

- a) të miratojë të gjitha masat e nevojshme, duke përfshirë sanksionet dhe masat korrigjuese të përshtatshme, me qëllim që të sigurojë zbatimin efektiv të dispozitave të Konventës; dhe
- b) të ngrejë shërbime të inspektimit të përshtatshme, me qëllim që të kontrollojë zbatimin e masave që do të merren në përputhje me Konventën dhe t'i pajisë këto shërbime me burimet njerëzore të nevojshme për plotësimin e detyrave të tyre.

### PJESA V DISPOZITAT FINALE

#### Neni 17

Ratifikimet zyrtare të kësaj Konvente do t'i komunikohen Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe do të regjistrohen prej tij.

#### Neni 18

1. Kjo Konventë do të lidhë vetëm Anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ratifikimi i së cilës do të jetë regjistruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës.
2. Ajo do të hyjë në fuqi 12 muaj pasi të jenë regjistruar nga Drejtori i Përgjithshëm ratifikimet e dy Anëtarëve.
3. Në vazhdim, kjo Konventë do të hyjë në fuqi për çdo Anëtar 12 muaj pas datës kur ratifikimi i saj do të jetë regjistruar.

#### Neni 19

1. Çdo Anëtar që ka ratifikuar këtë Konventë mund ta denoncojë atë në mbarim të një periudhe dhjetëvjeçare pas datës së hyrjes fillestare në fuqi të Konventës, me anë të një akti që i komunikohet Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe të regjistruar prej tij.
2. Çdo Anëtar që ka ratifikuar këtë Konventë, i cili, brenda një viti pas mbarimit të periudhës dhjetëvjeçare përmendur në paragrafin e mësipërm, nuk do të përdorë të drejtën e denoncimit të parashikuar nga ky nen, do të lidhet për një periudhë të re dhjetëvjeçare, dhe në vazhdim do të mund ta denoncojë këtë Konventë në mbarim të çdo periudhe dhjetëvjeçare në kushtet e parashikuara nga ky nen.

#### Neni 20

1. Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës do t'u njoftojë të gjithë Anëtarëve të Organizatës Ndërkombëtare të Punës regjistrimin e të gjitha ratifikimeve dhe denoncimeve që i janë

komunikuar atij nga Anëtarët e Organizatës.

2. Duke iu njoftuar Anëtarëve të Organizatës ratifikimin e dytë, që i është komunikuar, Drejtori i Përgjithshëm tërheq vëmendjen e Anëtarëve të Organizatës mbi datën në të cilën kjo Konventë do të hyjë në fuqi.

Neni 21

Drejtori i Përgjithshëm Zyrës Ndërkombëtare të Punës do t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, për qëllime regjistrimi, në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, të dhëna të plota mbi të gjitha ratifikimet dhe mbi të gjitha aktet e denoncimit që ai do të ketë regjistruar në përputhje me nenet e mësipërme.

Neni 22

Sa herë që do ta gjykojë të nevojshme, Këshilli Administrativ i Zyrës Ndërkombëtare të Punës do t'i paraqesë Konferencës së Përgjithshme një raport mbi zbatimin e kësaj Konvente dhe do të shqyrtojë, nëse do të duhet, të regjistrojë në rendin e ditës së Konferencës çështjen e rishikimit të saj të pjesshëm ose të plotë.

Neni 23

1. Në rastin kur Konferenca do të miratonte një konventë të re, që mban rishikimin e plotë apo të pjesshëm të kësaj Konvente dhe nëse konventa e re nuk parashikon ndryshe:

a) ratifikimi nga një Anëtar i konventës së re që mban rishikimin do të sillte me plot të drejtë, pavarësisht nga neni 19 më sipër, denoncimin e menjëhershëm të kësaj Konvente, me kusht që konventa e re që bën rishikimin të ketë hyrë në fuqi.

b) duke u nisur nga data e hyrjes në fuqi të konventës së re që bën rishikimin, kjo Konventë do të pushojë së qeni e hapur për ratifikim për Anëtarët.

2. Kjo Konventë do të mbetet megjithatë në fuqi në formën dhe përmbajtjen e saj për Anëtarët, të cilët do ta kishin ratifikuar dhe që nuk do të ratifikonin Konventën që bën rishikimin.

Neni 24

Versionet në anglisht dhe në frëngjisht të tekstit të kësaj Konvente janë të barasvlefshëm.

## **L I G J**

**Nr. 8939, datë 12.9.2002**

### **PËR RATIFIKIMIN E “KONVENTËS NR. 175 “PUNA ME KOHË TË PJESSHME, 1994” TË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

## **K U V E N D I**

### **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I :**

Neni 1

Ratifikohet “Konventa nr.175 “Puna me kohë të pjesshme, 1994” e Organizatës Ndërkombëtare të Punës”.

## Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3482, datë 7.10.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Alfred Moisiu**

### KONVENTA NR. 175 KONVENTA LIDHUR ME PUNËN ME KOHË TË PJESSHME

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, e thirrur në Gjenevë nga Këshilli Administrativ i Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe e mbledhur më 7 qershor 1994, në sesionin e saj të 81-të;

duke nënvizuar rëndësinë, për punonjësit me kohë të pjesshme, të dispozitave të konventës mbi barazinë e shpërblimit, 1951; të konventës lidhur me diskriminimin (punësim dhe profesion), 1958; dhe të konventës dhe rekomandimit mbi punonjës që kanë përgjegjësi familjare, 1981;

duke nënvizuar gjithashtu rëndësinë, për këta punonjës, e konventës mbi nxitjen e punësimit dhe mbrojtjen nga papunësia, 1988, dhe të rekomandimit lidhur me politikën e punësimit (dispozita plotësuese), 1984;

duke njohur rëndësinë që merr për të gjithë punëtorët një punësim produktiv dhe i zgjedhur lirisht, rëndësinë e punës me kohë të pjesshme për ekonominë, nevojën për politikën e punësimit për të marrë në konsideratë rolin që luan puna me kohë të pjesshme në krijimin e mundësive suplementare të punësimit dhe nevojën për të siguruar mbrojtjen e punonjësve me kohë të pjesshme në fushat e aksesit në punësim, kushteve të punës dhe sigurimeve shoqërore;

pasi kanë vendosur të miratojnë propozime të ndryshme lidhur me punën me kohë të pjesshme, çështje që përbën pikën e katërt të rendit të ditës së sesionit;

pasi kanë vendosur që këto propozime të marrin formën e një konvente ndërkombëtare.

Miraton, ditën e 24 qershorit 1994, Konventën e mëposhtme, e cila do të quhet Konventa mbi punën me kohë të pjesshme, 1994.

## Neni 1

Për qëllime të kësaj Konvente:

a) shprehja “punonjës me kohë të pjesshme” tregon një punonjës rrogëtar, kohëzgjatja normale e të cilit është më e ulët se ajo e punonjësve me kohë të plotë të ndodhur në një situatë të krahasueshme;

b) kohëzgjatja normale e punës e përmendur në paragrafin a) mund të llogaritet mbi një bazë javore ose mesatarisht gjatë një periudhe punësimi të dhënë;

c) shprehja “punonjës me kohë të plotë i ndodhur në një situatë të krahasueshme” i referohet një punëtori me kohë të plotë:

- që ka të njëjtin tip marrëdhënieje punësimi;

- që kryen të njëjtin tip pune ose një tip pune të ngjashëm, ose që ushtron të njëjtin tip profesioni, ose një tip profesioni të ngjashëm;

- i punësuar në të njëjtin institucion ose, në mungesë të punonjësve me kohë të plotë, i ndodhur në një situatë të krahasueshme në këtë institucion, në të njëjtën ndërmarrje ose, në mungesë të punonjësve me kohë të plotë, i ndodhur në një situatë të krahasueshme në këtë ndërmarrje, në të njëjtën degë aktiviteti, si punëtori i përmendur me kohë të pjesshme;

d) punonjësit me kohë të plotë në papunësi të pjesshme, domethënë të prekur nga një reduktim kolektiv dhe i përkohshëm i kohëzgjatjes së tyre normale të punës për arsye ekonomike, teknike apo strukturore, nuk konsiderohen si punonjës me kohë të pjesshme.

## Neni 2

Kjo Konventë nuk prek dispozitat më të favorshme të konventave të tjera ndërkombëtare të zbatueshme ndaj punonjësve me kohë të pjesshme.

#### Neni 3

1. Kjo Konventë zbatohet mbi të gjithë punonjësit me kohë të pjesshme, duke ditur që një Anëtar mund, pas konsultash me organizatat më të përfaqësuara të punëdhënësve dhe punëmarrësve të interesuar, të përjashtojë plotësisht apo pjesërisht nga fusha e saj e aplikimit kategori të veçanta punonjësish apo ndërmarrjesh, kur zbatimi i saj ndaj tyre ngre probleme të veçanta të një rëndësie që nuk mund të neglizhohet.

2. Çdo Anëtar i cili ratifikon këtë Konventë dhe që zbaton mundësinë e ofruar në paragrafin paraardhës duhet, në raportet e tij mbi aplikimin e Konventës të paraqitura sipas nenit 22 të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, të tregojë çdo kategori të veçantë punonjësish apo ndërmarrjesh të përjashtuara, si dhe arsyet për të cilat ky përjashtim ka qenë dhe mbetet i nevojshëm.

#### Neni 4

Duhet marrë masa me qëllim që punonjësit me kohë të pjesshme të përfitojnë të njëjtën mbrojtje si ajo që përfitojnë punonjësit me kohë të plotë; duke u ndodhur në një situatë të krahasueshme për sa i përket:

- a) të drejtës së organizimit, të drejtës së negocimit kolektiv dhe të drejtës së veprimit në cilësinë e përfaqësuesve të punëmarrësve;
- b) sigurisë dhe shëndetit në punë;
- c) diskriminimit në punësim dhe në profesion.

#### Neni 5

Duhet marrë masa, në përputhje me legjislacionin dhe praktikën kombëtare, që punonjësit me kohë të pjesshme të mos marrin, për të vetmen arsye se ata punojnë në kohë të pjesshme, një rrogë bazë, e cila, e llogaritur në mënyrë proporcionale mbi një bazë orësh, rendimenti apo me copë, të jetë më e vogël se rroga bazë, e llogaritur sipas të njëjtës metodë, e punonjësve me kohë të plotë të ndodhur në të njëjtën situatë të krahasueshme.

#### Neni 6

Regjimet legale të sigurisë sociale që janë të lidhura me ushtrimin e një aktiviteti profesional duhet të përshtaten në mënyrë të tillë që punonjësit me kohë të pjesshme të përfitojnë nga kushtet ekuivalente me ato të punonjësve me kohë të plotë të ndodhur në një situatë të krahasueshme; këto kushte do të mund të përcaktohen në proporcion me kohëzgjatjen e punës, kuotizacionet ose fitimet, ose me metoda të tjera, në përputhje me legjislacionin dhe praktikën kombëtare.

#### Neni 7

Duhet marrë masa, me qëllim që punonjësit me kohë të pjesshme të përfitojnë nga kushte ekuivalente me ato të punonjësve me kohë të plotë të ndodhur në një situatë të krahasueshme në fushat e mëposhtme:

- a) mbrojtja e mëmësisë;
  - b) ndërprerja e marrëdhënieve të punës;
  - c) leje vjetore e paguar dhe ditë pushimi (festash) të paguara;
  - d) pushime për sëmundje;
- duke ditur që këto pagesa në para do të mund të përcaktohen në proporcion me kohëzgjatjen e punës apo fitimin.

## Neni 8

1. Punonjësit me kohë të pjesshme, kohëzgjatja e punës apo fitimi i të cilëve janë më të ulta se disa pragje të përcaktuara, do të mund të përjashtohen nga Anëtar:

a) nga fusha e zbatimit të ndonjërit prej regjimeve ligjore të sigurimeve shoqërore të parashikuar në nenin 6, me përjashtim të rasteve të pagesave për aksidente në punë dhe sëmundje profesionale;

b) nga fusha e zbatimit e ndonjëres prej masave të miratuara në fushat e përmendura në nenin 7, me përjashtim të masave mbrojtëse të mëmësisë, përveç atyre që janë parashikuar nga regjimet legale të sigurimeve shoqërore.

2. Pragjet e përmendura në paragrafin 1 duhet të jenë në mënyrë të mjaftueshme të ulta për të mos përjashtuar një përqindje të lartë pa të drejtë të punonjësve me kohë të pjesshme.

3. Një Anëtar që përfiton nga mundësia e parashikuar në paragrafin 1 si më sipër duhet:

a) të rishikojë periodikisht pragjet në fuqi;

b) të saktësojë, në raportet e tij mbi zbatimin e konventës të paraqitur, në bazë të nenit 22 të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, pragjet në fuqi dhe arsyet e tyre dhe të tregojë nëse synohet të shtrihet progresivisht mbrojtja ndaj punonjësve të përjashtuar.

4. Organizatat më të përfaqësuara të punëdhënësve dhe të punëmarrësve duhet të konsultohen në lidhje me fiksimin, rishqyrtimin dhe rishikimin e pragjeve të parashikuara në këtë nen.

## Neni 9

1. Duhet marrë masa për të lehtësuar aksesin në punën me kohë të pjesshme produktive dhe e zgjedhur në mënyrë të lirë, e cila u përgjigjet si nevojave të punëdhënësve, ashtu dhe të punëmarrësve, me kusht që mbrojtja e parashikuar në nenet 4 dhe 7, si më sipër të jetë e siguruar.

2. Këto masa duhet të përmbajnë:

a) rishqyrtimin e dispozitave të legjislacionit, që mund të pengojnë ose të inkurajojnë punën me kohë të pjesshme ose pranimin e këtij tipi pune;

b) përdorimin e shërbimeve të punësimit kur ato ekzistojnë për t'i identifikuar dhe për t'i bërë të njohura mundësitë e punës me kohë të pjesshme gjatë veprimtarive të tyre informuese dhe ndërmjetësuese;

c) një vëmendje të veçantë, në kuadrin e politikave të punësimit, ndaj nevojave dhe preferencave të grupeve specifike të tillë si të papunë, punonjës që kanë përgjegjësi familjare, punonjës të moshuar, punonjës hendikap dhe punonjës që punojnë ose janë në formim (kualifikim).

3. Këto masa mund të përmbajnë, gjithashtu, kërkime dhe shpërndarjen e informacioneve mbi masën në të cilën puna me kohë të përkohshme u përgjigjet objektivave ekonomike dhe sociale të punëdhënësve dhe punëmarrësve.

## Neni 10

Në rastet e duhura, duhet marrë masa me qëllim që transferta nga një punë me kohë të plotë në një punë me kohë të pjesshme ose e anasjellta, të jetë vullnetare, në përputhje me legjislacionin dhe praktikën kombëtare.

## Neni 11

Dispozitat e kësaj Konvente duhet të vihen në jetë nëpërmjet legjislacionit, përveçse kur atyre u jepet fuqi me anë të marrëveshjeve kolektive ose me çdo lloj mjeti tjetër në përputhje me praktikën kombëtare. Organizatat më të përfaqësuara të punëdhënësve dhe punëmarrësve duhet të konsultohen paraprakisht për miratimin e një legjislacioni të tillë.

## Neni 12

Ratifikimet zyrtare të kësaj Konvente do t'i komunikohen Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe do të regjistrohen prej tij.

#### Neni 13

1. Kjo konventë do të lidhë vetëm Anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ratifikimi i së cilës do të ketë qenë i regjistruar nga Drejtori i Përgjithshëm.
2. Ajo do të hyjë në fuqi 12 muaj pasi ratifikimet e dy Anëtarëve do të kenë qenë të regjistruara nga Drejtori i Përgjithshëm.
3. Më pas, kjo Konventë do të hyjë në fuqi për çdo Anëtar 12 muaj pas datës në të cilën ratifikimi i saj do të jetë regjistruar.

#### Neni 14

1. Çdo Anëtar që ka ratifikuar këtë Konventë mund ta denoncojë atë në mbarim të një periudhe dhjetëvjeçare pas datës së hyrjes fillestare në fuqi të Konventës, me anë të një akti që i komunikohet Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe të regjistruar prej tij. Denoncimi do të marrë forcë vetëm pas një viti nga regjistrimi i saj.
2. Çdo Anëtar që ka ratifikuar këtë Konventë, i cili, në afatin e një viti pas mbarimit të periudhës dhjetëvjeçare të përmendur në paragrafin e mësipërm nuk do të përdorë të drejtën e denoncimit të parashikuar nga ky nen, do të lidhet për një periudhë të re dhjetëvjeçare, dhe, në vazhdim, do të mund të denoncojë këtë Konventë në mbarim të çdo periudhe dhjetëvjeçare në kushtet e parashikuara në këtë nen.

#### Neni 15

1. Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës do t'i njoftojë të gjithë Anëtarëve të Organizatës Ndërkombëtare të Punës regjistrimin e të gjitha ratifikimeve dhe denoncimeve që do t'i komunikohen atij nga Anëtarët e Organizatës.
2. Duke u njoftuar Anëtarëve të Organizatës regjistrimin e ratifikimit të dytë që do t'i jetë komunikuar atij, Drejtori i Përgjithshëm do të tërheqë vëmendjen e Anëtarëve të Organizatës mbi datën në të cilën kjo Konventë do të hyjë në fuqi.

#### Neni 16

Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës do t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, për qëllime regjistrimi, në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, të dhëna të plota lidhur me çdo ratifikim ose akt denoncimi që ai do të ketë regjistruar në përputhje me nenet e mësipërme.

#### Neni 17

Sa herë që do ta gjykojë të nevojshme, Këshilli Administrativ i Zyrës Ndërkombëtare të punës do t'i paraqesë Konferencës së Përgjithshme një raport mbi zbatimin e kësaj Konvente dhe do të shqyrtojë, nëse ka vend, regjistrimin në rendin e ditës të çështjes së rishikimit të saj total ose të pjesshëm.

#### Neni 18

1. Në rastin kur Konferenca do të miratonte një konventë të re, që do të rishikonte në mënyrë të plotë ose të pjesshme këtë Konventë, dhe nëse konventa e re nuk parashikon ndryshe:
  - a) ratifikimi nga një Anëtar i konventës së re që bën rishikimin, do të sillte me plot të drejtë, pavarësisht nenit 14 më sipër, denoncimin e menjëhershëm të kësaj Konvente, me kusht që konventa e re që bën rishikimin të ketë hyrë në fuqi;
  - b) duke u nisur nga data e hyrjes në fuqi të konventës së re që përmban rishikim, kjo Konventë do të pushonte së qeni e hapur për ratifikim të Anëtarëve.
2. Kjo Konventë do të mbetet megjithatë në fuqi në formë dhe në përmbajtje për Anëtarët që

do ta kishin ratifikuar dhe që nuk do të ratifikonin Konventën që përmban rishikim.

#### Neni 19

Versionet frengjisht dhe anglisht të tekstit të kësaj Konvente janë të njëjtë.

### **L I G J** **Nr. 8940, datë 12.9.2002**

#### **PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË BULLGARISË PËR SHËRBIMET AJRORE NDËRMJET DHE PËRTEJ TERRITOREVE TË TYRE RESPEKTIVE”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

### **K U V E N D I**

#### **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:**

#### Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Q everisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Bullgarisë për shërbimet ajrore ndërmjet dhe përtej territoreve të tyre respektive”, nënshkruar në Sofje më 21 mars 2002.

#### Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3491, datë 10.10.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Alfred Moisiu**

#### **MARRËVESHJE** **NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS** **TË BULLGARISË PËR SHËRBIMET AJRORE NDËRMJET DHE PËRTEJ TERRITOREVE TË** **TYRE RESPEKTIVE**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Bullgarisë, këtu e më poshtë referuar si “Palë Kontraktuese”:

duke pohuar aderimin e tyre në Konventën mbi aviacionin civil ndërkombëtar, të hapur për nënshkrim në Çikago më 7 dhjetor 1944;

duke konfirmuar vullnetin e tyre për të kontribuar në përparimin e aviacionit civil ndërkombëtar;

për të siguruar mundësi të ndershme dhe të barabarta për shoqëritë ajrore të tyre, të përcaktuar për të konkurruar në kushtet e transportit ajror ndërkombëtar të sigurt, adekuat dhe efikas;

me dëshirën për të konkluduar një marrëveshje, me qëllim krijimin e shërbimeve ajrore ndërmjet dhe përtej territoreve të tyre respektive;

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1  
**Përkufizime**

Për qëllim të interpretimit dhe të aplikimit të kësaj Marrëveshjeje dhe të anekseve të saj, nëse përmbajtja nuk e kërkon ndryshe:

a) Termi “Konventë” nënkupton Konventën mbi aviacionin civil ndërkombëtar, të hapur për nënshkrim në Çikago më 7 dhjetor 1944, dhe që përfshin çdo aneks të përshtatur sipas nenit 90 të kësaj Konvente dhe çdo amendament të anekseve ose të Konventës sipas nenit 90 dhe 94, për aq kohë sa këto anekse dhe amendamente kanë hyrë në fuqi ose janë ratifikuar nga të dy Palët Kontraktuese.

b) Termi “autoritet aeronautik” nënkupton për Republikën e Shqipërisë Ministrinë e Transportit, për Republikën e Bullgarisë Ministrinë e Transportit dhe të Komunikacionit në personin e Drejtorisë së Përgjithshme të “Administratës së aviacionit civil” ose, në një rast tjetër, çdo person ose organ të autorizuar për të kryer funksionet që ushtrohen aktualisht nga autoritetet në fjalë.

c) Termi “shoqëri ajrore e përcaktuar” nënkupton një shoqëri, e cila është përcaktuar dhe autorizuar në përputhje me nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

d) Termi “territor” në lidhje me një shtet ka nënkuptimin e përcaktuar sipas nenit 2 të Konventës.

e) Termi “shërbim ajror”, “shërbim ajror ndërkombëtar”, “shoqëri ajrore” dhe “ndalesa për qëllime jo-trafiku” ka nënkuptim respektiv sipas nenit 96 të Konventës.

f) Termi “shërbim i miratuar” dhe “rrugë specifike” nënkupton respektivisht shërbimin ajror ndërkombëtar, në përputhje me nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe rrugët e specifikuar në aneksin e kësaj Marrëveshjeje.

g) Termi “rezerva” nënkupton artikujt e një natyre të konsumueshme, të gatshme për përdorim ose shitje në bord të avionit gjatë fluturimit, përfshirë furnizimet për personelin.

h) Termi “Marrëveshje” nënkupton këtë Marrëveshje, aneksin e saj, të hartuara për aplikim dhe çdo amendament të kësaj Marrëveshjeje ose të këtij aneksi.

i) Termi “tarifë” nënkupton çmimin që do të vihet për transportimin ndërkombëtar të pasagjerëve, bagazheve ose kargos (duke përfshirë postën) dhe përfshin:

- çdo tarifë ose shumë tjetër, që do të vihet për transportimin ndërkombëtar, të tregtuara dhe të shitura si të tilla, duke përfshirë tarifa të përcaktuara, duke përdorur tarifa të tjera ose shtesa për transportimin në sektorët ndërkombëtarë ose në sektorët e brendshëm, që formojnë pjesë të sektorëve ndërkombëtarë;

- komisionin, që duhet të paguhet mbi shitjen e biletave për transportimin e pasagjerëve dhe të bagazheve të tyre ose në transaksionet korresponduese për transportimin e kargos; dhe

- kushtet që rregullojnë aplikueshmërinë e tarifës ose të çmimit për transportimin, ose pagesën e komisionit;

Gjithashtu, përfshin:

- çdo përfitim domethënës, që përfitohet në lidhje me transportimin;

- çdo tarifë për transportimin në një sektor të brendshëm, e cila është shitur si një shtesë e transportit ndërkombëtar, që nuk është e vlefshme për udhëtime thjesht të brendshme dhe që nuk është bërë e vlefshme në terma të barabarta për të gjithë transportet ndërkombëtare dhe përdoruesit e këtyre shërbimeve.

k) Termi “kapacitet” në lidhje me një avion nënkupton ngarkesën e avionit, e vlefshme në rrugë ose në sektorë të një rruge.

l) Termi “kapacitet” në lidhje me një shërbim të miratuar nënkupton kapacitetin e avionit, të përdorur për këto shërbime, shumëzuar me frekuencën e fluturimeve që kryen një avion i tillë për një periudhë të dhënë kohe dhe në një rrugë ose sektor të rrugës.

m) Termi “taksë përdorimi” nënkupton një taksë, që i vendoset shoqërive ajrore nga autoritetet kompetente ose nga ato të lejuara nga këto autoritete, për kushtet e pronësisë ose lehtësirave të aeroportit, ose mjeteve ndihmëse të navigimit ajror, përfshirë shërbimet dhe lehtësirat përkatëse për avionin, ekuipazhet e tyre, pasagjerët dhe kargon.

Neni 2  
**Dhënia e të drejtave**

1. Çdo Palë Kontraktuese i garanton Palës tjetër Kontraktuese të drejtat e specifikuar në këtë Marrëveshje për qëllim të krijimit dhe operimit të shërbimeve ajrore ndërkombëtare të planifikuara ndërmjet territorit të tij dhe territorit të Palës tjetër Kontraktuese mbi rrugët e specifikuar në aneks. Shërbime dhe rrugë të tilla, këtu dhe më poshtë, do të quhen respektivisht “shërbime të miratuara” dhe “rrugë specifike”. Shoqëria ajrore e përcaktuar e çdo Pale Kontraktuese do të gëzojë të drejtën për të ndaluar në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, në pikat e specifikuar në aneks për qëllim të marrjes në bord dhe të zbritjes së trafikut ndërkombëtar të pasagjerëve, kargos dhe postës, të destinuar për në ose që vijnë nga pikat në territoret në fjalë, gjatë kohës që kryen një shërbim të miratuar në një rrugë specifike.

2. Dispozitat e paragrafit (1) të këtij neni nuk duhet të gjykohen si dhënie privilegji një shoqërie ajrore të një Palë Kontraktuese për të marrë në bord, në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, pasagjerët, bagazhet, kargon ose postën, të transportuar me qira ose shpërblim dhe të destinuar në një pikë tjetër në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

3. Në shtesë të të drejtave të dhëna në paragrafin (1) të këtij neni, çdo Palë Kontraktuese, gjithashtu, i jep shoqërisë ajrore të Palës tjetër Kontraktuese, për shërbimet ajrore ndërkombëtare:

- a) të drejtën të fluturojë mbi territorin e saj pa ndaluar në të; dhe
- b) të drejtën të ulet në një territor të tillë për qëllime jo trafiku.

4. Çdo Palë Kontraktuese pranon që avioni civil i Palës tjetër Kontraktuese, i cili nuk kryen shërbime ajrore të rregullta ndërkombëtare, të gëzojë të drejtat e specifikuar në nënparagrafët (a) dhe (b) të paragrafit 3 të nenit 2, pasi të ketë marrë më parë leje nga Pala Kontraktuese pranuese.

5. Avioni civil, nëse angazhohet në transportin e pasagjerëve, kargos ose postës me shpërblim ose qira në shërbime jo të rregullta ajrore ndërkombëtare, do të ketë privilegjin e marrjes ose të zbritjes së pasagjerëve, bagazheve, kargos ose postës, subjekt i të drejtave të ndonjë Pale Kontraktuese, kur këto ngarkime ose zbritje do të imponojnë rregulla, kushte ose kufizime të tilla, të cilat konsiderohen të dëshirueshme.

### Neni 3

#### **Përcaktimi dhe autorizimi i operimeve**

1. Çdo Palë Kontraktuese do të ketë të drejtën të përcaktojë një shoqëri ajrore ose disa shoqëri ajrore, me qëllim operimin e shërbimeve të miratuara mbi rrugët e specifikuar dhe të tërheqë, të ndryshojë ose të shmangë përcaktime të tilla. Këto përcaktime duhet të bëhen me shkrim dhe duhet t'i transmetohen Palës tjetër Kontraktuese me anë të notave diplomatike.

a) Në rast se një Palë Kontraktuese dëshiron të përcaktojë më shumë se një shoqëri ajrore, autoritetet aeronautike duhet të konsultohen në përputhje me nenin 18 të kësaj Marrëveshjeje. Një marrëveshje e përbashkët e bazuar mbi parimet e vendosura në nenin 5 të paragrafit (1), (2) dhe (3) është e nevojshme për përcaktime të tjera të mëtejshme.

2. Me marrjen e një përcaktimi të tillë të bërë nga një Palë Kontraktuese, në përputhje me paragrafin (1) më sipër dhe të një aplikimi nga shoqëritë ajrore të përcaktuara për autorizimin e operimit, autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese duhet, në përputhje me ligjet dhe rregullat kombëtare, të lëshojnë autorizimin e operimit përkatës, që siguron se:

a) pronësia aktuale dhe kontrolli efektiv i kësaj shoqërie ajrore janë të vlefshme në Palën Kontraktuese përcaktuese të shoqërisë ajrore ose në shtetasit e saj;

b) shoqëria ajrore e përcaktuar është e kualifikuar që të plotësojë kushtet e përshkruara sipas ligjeve dhe rregullave që normalisht aplikohen për operimin e shërbimeve ajrore ndërkombëtare nga Pala Kontraktuese, duke pasur parasysh aplikimin, në përputhje me dispozitat e Konventës;

c) shoqëria ajrore e përcaktuar është e kualifikuar që të plotësojë kushtet e përshkruara sipas kësaj Marrëveshjeje.

3. Në rast të një çështjeje të diskutueshme për lëshimin e autorizimit të operimit, autoritetet aeronautike të Palës Kontraktuese, të cilat kanë dhënë autorizimin në fjalë, nuk japin ndonjë provë bindëse ose nuk janë të kënaqura me plotësimin e kërkesave të parashtruara në paragrafin 2 të këtij neni nga shoqëria ajrore e përcaktuar e Palës tjetër Kontraktuese, kanë të drejtën të refuzojnë, të vonojnë ose të kufizojnë autorizimet e lëshuara për operim, të kërkojnë konsultime ose të imponojnë kushte të tilla, të cilat ato i gjykojnë të nevojshme sipas rastit.

4. Kur një shoqëri ajrore është e përcaktuar dhe autorizuar, në përputhje me termat e këtij neni,

ajo në çdo kohë mund të fillojë të operojë në ndonjë shërbim të miratuar, duke siguruar që grafiku dhe tarifat e vendosura në përputhje me dispozitat e nenit 6 dhe 9 të kësaj Marrëveshjeje janë në fuqi në lidhje me këtë shërbim.

#### Neni 4

##### **Anulimi ose pezullimi i autorizimit të operimit**

1. Palët Kontraktuese kanë të drejtë të bllokojnë autorizimet e referuara në nenin 2 në lidhje me një shoqëri ajrore të përcaktuar nga një Palë tjetër Kontraktuese, të kufizojnë, të anulojnë ose të pezullojnë autorizime të tilla ose të imponojnë kushte:

a) në rast të dështimit prej kësaj shoqërie ajrore, të kualifikohet para autoriteteve aeronautike të kësaj Pale Kontraktuese sipas ligjeve dhe rregullave, të aplikueshme normalisht dhe në mënyrë të arsyeshme nga këto autoritete, në përputhje me Konventën dhe anekset e saj;

b) në rast të dështimit prej kësaj shoqërie ajrore, të plotësojë ligjet ose rregullat e kësaj Pale Kontraktuese;

c) në rast se ato nuk janë të bindura që pronësia aktuale dhe kontrolli efektiv i shoqërisë ajrore janë të aprovuara në Palën Kontraktuese që përcakton shoqërinë ajrore ose për shtetasit e saj ose për të dyja bashkë;

d) në rast se shoqëria ajrore nuk operon në përputhje me kushtet e përshkruara në këtë Marrëveshje;

e) në rast se Pala tjetër Kontraktuese, pa një njoftim të mëparshëm në formën e duhur, shmanget nga ose nuk mban dhe administron thjeshtëzimin e formaliteteve, standardeve të sigurisë dhe sigurimit, praktikave ose të rekomandimeve, të cilat janë vendosur në përputhje me Konventën

dhe anekset e saj, në lidhje me mjetet ndihmëse aeronautike, ekuipazhin ajror, avionin, operimin e shoqërisë ajrore të përcaktuar.

2. Të drejtat e dhëna në paragrafin (1) të këtij neni do të ushtrohen vetëm pas konsultimeve me autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese, nëse nuk është i domosdoshëm një veprim i menjëhershëm për të parandaluar thyerje të mëtejshme të ligjeve dhe rregullave të referuara më sipër. Këto konsultime duhet të fillojnë brenda një periudhe prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga data e marrjes së kërkesës, nëse nuk është pranuar ndryshe nga Palët Kontraktuese.

#### Neni 5

##### **Kapaciteti dhe parimet drejtuese të operimeve të shërbimeve të miratuara**

1. Duhet të ketë mundësi të ndershme dhe të barabarta për shoqëritë ajrore të përcaktuara të të dyja Palëve Kontraktuese për të operuar në shërbimet e miratuara mbi rrugët e specifikuara ndërmjet territoreve të tyre respektive.

2. Në ushtrimin e shërbimeve të miratuara, shoqëria ajrore e përcaktuar e një Pale Kontraktuese duhet të marrë në konsideratë interesat e shoqërisë ajrore të përcaktuar të Palës tjetër Kontraktuese, për të mos ndikuar tej mase në rezultatet e shërbimeve të shoqërisë ajrore ose të shoqërive ajrore në të gjithë ose në pjesë të së njëjtës rrugë.

3. Kapaciteti i ofruar nga shoqëritë ajrore të përcaktuara të Palëve Kontraktuese mbi shërbimet e miratuara duhet të jetë i lidhur ngushtë me kërkesat e publikut për transportimin në rrugët e specifikuara dhe secila nga shoqëritë ajrore të përcaktuara duhet të ketë si objektiv primar sigurimin e shërbimeve, sipas një ngarkese të arsyeshme e të përshtatshme për kërkesat aktuale e të pritshme ndërmjet territoreve të Palëve Kontraktuese.

4. E drejta për të ngarkuar ose shkarkuar, në shërbimet e miratuara, trafikun ndërkombëtar të pasagjerëve, të bagazheve, të kargos dhe postës, të destinuar për ne dhe të ardhura nga një vend i tretë, në një pikë ose pika të rrugëve të specifikuara në këtë Marrëveshje, duhet të ushtrohet në përputhje me parimin e përgjithshëm që kapaciteti duhet të jetë i lidhur me:

a) kërkesat e trafikut ndërmjet vendit të origjinës dhe vendit të destinacionit të fundit të trafikut;

b) kërkesat e shërbimeve ajrore të ndërmjetme dhe ekonomike; dhe

c) kërkesat e trafikut të zonës, nëpërmjet të cilës kalon shërbimi i miratuar, mbasi të jenë marrë në konsideratë shërbimet lokale dhe rajonale të ofruara nga shoqëritë ajrore të shteteve.

5. Konsultimet ndërmjet Palëve Kontraktuese duhet të bëhen sa herë që një Palë kërkon që kapaciteti i dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje të rishikohet, për të siguruar aplikimin e parimeve të këtij neni, që menaxhon drejtimin e shërbimeve.

## Neni 6 Tarifat

Tarifat që do të aplikohen nga shoqëritë e përcaktuara ajrore të një Pale Kontraktuese për transportimin në ose nga territori i një Pale tjetër Kontraktuese duhet të vendosen në nivele të arsyeshme, duke i kushtuar vëmendjen e duhur të gjithë faktorëve përkatës, duke përfshirë interesat e përdoruesve, koston e operimit, karakteristikat e shërbimit, përqindjet e komisionit, përfitimin e arsyeshëm, tarifat e shoqërive të tjera ajrore dhe konsiderata të tjera në treg.

Tarifat e referuara në paragrafin (1) të këtij neni, kur është e mundur, duhet të vendosen nga një marrëveshje e përbashkët e shoqërive të përcaktuara ajrore që i përkasin të dyja Palëve Kontraktuese, mbas konsultimit me shoqëritë e tjera ajrore, që operojnë mbi të gjithë ose mbi pjesë të së njëjtës rrugë. Kjo Marrëveshje, kur është e mundur, duhet të arrihet duke përdorur mekanizmin e koordinimit të tarifës të Shoqërisë së Transportit Ajror Ndërkombëtar.

Tarifat e miratuara në këtë mënyrë do të jenë subjekt i miratimit nga autoritetet aeronautike të të dyja Palëve Kontraktuese. Këto plotësime mund të kërkojnë jo më shumë se 45 (dyzet e pesë) ditë para datës së propozuar për prezantimin e tyre. Në raste të veçanta, kjo periudhë maksimale mund të zvogëlohet me konsensus të përbashkët ndërmjet autoriteteve aeronautike.

Miratimi i tarifave të përcaktuara sipas dispozitave të paragrafëve (2) dhe (3) më sipër mund të jepet respektivisht prej secilit nga autoritetet aeronautike të të dyja Palëve Kontraktuese. Megjithatë, nëse asnjë nga autoritetet aeronautike të Palëve Kontraktuese nuk ka dorëzuar me shkrim tek Pala tjetër njoftimin e mosmiratimit të tarifave të tilla të shoqërisë (ve) ajrore të Palës tjetër brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e dorëzimit, tarifat përkatëse do të konsiderohen të miratuara. Në rast se periudha e dorëzimit do të reduktohet në përputhje me paragrafin (3) më sipër, Palët mund të bien dakort që periudha brenda së cilës mund të dorëzohet mosmiratimi mund të reduktohet respektivisht. Asnjë tarifë nuk mund të hyjë në fuqi nëse ndonjëra nga Palët Kontraktuese ka dhënë njoftimin për mosmiratim.

Autoritetet aeronautike të njëres Palë Kontraktuese mund të kërkojnë konsultime në lidhje me çdo tarifë të propozuar për shërbimet e miratuara, kur tarifa përkatëse ka qenë subjekt i një njoftimi të mosmiratimit ose nuk mund të pranohet në përputhje me paragrafin (2) më sipër. Këto konsultime duhet të mbahen jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë pas marrjes së kërkesës. Palët duhet të bashkëpunojnë në sigurimin e informacionit të nevojshëm shtesë për zgjidhje të arsyeshme të çështjeve.

Nëse autoritetet aeronautike të Palëve Kontraktuese nuk mund të zgjidhin një çështje në lidhje me tarifat, siç parashikohet në paragrafin (5) të këtij neni, mosmarrëveshja do të zgjidhet në përputhje me dispozitat e nenit 19 të kësaj Marrëveshjeje.

Një tarifë e vendosur në përputhje me dispozitat e këtij neni do të mbetet në fuqi deri në datën e skadimit ose derisa një tarifë e re të jetë miratuar. Sidoqoftë, një tarifë nuk mund të zgjatet më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj pas datës në të cilën ajo ka skaduar.

## Neni 7 Aktivitetet tregtare, transferimet e fondeve dhe përfaqësimi

1. Bazuar në parimet e reciprocitetit dhe në përputhje me ligjet dhe rregullat e aplikueshme kombëtare respektive, shoqëritë ajrore të përcaktuara të çdo Pale Kontraktuese kanë të drejtë të angazhohen direkt ose nëpërmjet agjentëve të caktuar nga këto shoqëri, në shitjen e transportit ajror në zonën e Palës tjetër Kontraktuese. Shoqëritë ajrore të përcaktuara të çdo Pale Kontraktuese kanë të drejtë të shesin në monedhën lokale ose në monedha të tjera të konvertueshme dhe çdo person ka të drejtën të blejë një transport të tillë.

2. Bazuar në parimet e reciprocitetit, çdo shoqëri ajrore e përcaktuar do të ketë të drejtën të konvertojë dhe të dërgojë në vendin e kërkuar prej saj të ardhurat lokale, të fituara nga këto shoqëri ajrore në lidhje me transportimin e pasagjerëve, kargos dhe postës, që dalin mbi shumat e lëvruara

lokalisht. Konvertimet dhe dërgesat duhet të lejohen pa kufizime në përqindjen e këmbimit, që aplikohet në transaksionet aktuale, e cila është në fuqi në kohën kur këto të ardhura paraqiten për konvertim dhe dërgim dhe nuk do të jetë subjekt i ndonjë detyrimi, përveç atyre të vendosura normalisht nga bankat për kryerjen e këtyre konvertimeve dhe dërgesave.

3. Të ardhurat dhe fitimet e marra nga shoqëria (të) ajrore të përcaktuara të një Pale Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, të ardhura nga transportimi i pasagjerëve, kargos dhe postës, duhet të përjashtohen nga taksat e të ardhurave dhe nga çdo taksë tjetër të imponuar nga Pala tjetër Kontraktuese. Përjashtimi që ofrohet më sipër do të aplikohet edhe për pjesëmarrjen në ndërmarrje e investime të përbashkëta.

4. Nëse disbursimet ose fitimet dhe taksimet e të ardhurave ndërmjet Palëve Kontraktuese vendosen me një marrëveshje speciale, atëherë do të aplikohet kjo marrëveshje speciale.

5. Shoqëria (të) e përcaktuara ajrore të një Pale Kontraktuese duhet të lejohen mbi bazën e reciprocitetit të mbajnë në territorin e një Pale tjetër Kontraktuese përfaqësuesit e tyre bashkë me stafin tregtar, operacional dhe teknik, siç kërkohet në lidhje me operimin e shërbimit të miratuar. Staf i tyre do të zgjidhet midis shtetasve të njëres ose të të dyja Palëve sipas nevojave.

6. Kërkesat e këtij stafi mund të plotësohen sipas nevojave të shoqërisë ajrore nga personeli i saj, duke përdorur shërbimet e një tjetër organizate, kompanie, shoqërie ajrore ose shoqërive ajrore, që operojnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese dhe janë të autorizuar të kryejnë shërbime të tilla në territorin e kësaj Pale Kontraktuese.

7. Përfaqësuesit dhe stafi janë subjekt i ligjeve dhe rregullave të Palës tjetër Kontraktuese në lidhje me hyrjen, qëndrimin dhe punësimin dhe, në përputhje me këto ligje dhe rregulla, çdo Palë Kontraktuese, mbi bazën e reciprocitetit, duhet të sigurojë për përfaqësuesit dhe stafin lejet e nevojshme të punës, vizat e punësimit ose dokumente të tjera të ngjashme, siç referohet në paragrafin (1) të këtij neni.

8. Shtetasit e një Pale Kontraktuese që punojnë për shoqërinë(të) ajrore të përcaktuara të kësaj Pale Kontraktuese në zyrat e përfaqësimit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, mbi bazën e lidhjeve të punës, janë të detyruar të sigurohen për të gjitha rastet e siguracionit, për të cilat shteti është përgjegjës, sipas legjislacionit të Palës Kontraktuese të cilit i është referuar së pari në këtë paragraf.

#### Neni 8

### **Konkurrenca e ndershme**

Duhet të ekzistojë mundësia e ndershme dhe e barabartë për shoqëritë ajrore të përcaktuara të të dyja Palëve Kontraktuese për të marrë pjesë në transportin ajror ndërkombëtar të mbuluar nga kjo Marrëveshje.

Çdo Palë Kontraktuese duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura brenda juridiksionit të saj për të eliminuar të gjitha format e diskriminimit ose praktikat konkurruese të pandershme, që influencojnë negativisht pozicionin konkurrues të shoqërive ajrore të Palës tjetër Kontraktuese.

#### Neni 9

### **Oraret**

Frekuencat dhe programet për operimin e shërbimeve të miratuara duhet të vendosen me anë të një marrëveshjeje të përbashkët nga shoqëritë ajrore të përcaktuara dhe duhet të dorëzohen tek autoritetet aeronautike për miratim të paktën 30 (tridhjetë) ditë para hyrjes së tyre në fuqi. Nëse një marrëveshje e tillë nuk mund të arrihet midis shoqërive ajrore të përcaktuara, çështja duhet të referohet tek autoritetet aeronautike të Palëve Kontraktuese.

Kërkesat për leje për të kryer fluturime shtesë mund të dorëzohen për miratim nga shoqëria ajrore e përcaktuar direkt pranë autoriteteve aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese.

#### Neni 10

### **Përjashtime nga doganat dhe detyrime të tjera**

1. Çdo Palë Kontraktuese, mbi bazat e reciprocitetit dhe aq sa lejojnë ligjet kombëtare, duhet të përjashtojnë shoqërinë (të) ajrore të përcaktuar të Palës tjetër Kontraktuese nga kufizimet e importit,

detyrimet doganore, taksat e akcizës kombëtare, pagesat e inspektimeve, detyrimet e tjera kombëtare dhe detyrimet mbi avionin, karburantin, vajrat lubrifikante, furnizimet teknike të konsumueshme, pjesët e ndërrimit, përfshirë motorrat, pajisjet e rregullta të avionëve, depot e avionëve (përfshirë pijet, duhanin dhe produkte të tjera të destinuara për shitje pasagjerëve në sasira të kufizuara gjatë fluturimit) dhe artikuj të tjerë (të specifikuar në paragrafin (2) më poshtë), që kanë për qëllim ose që përdoren vetëm për operimin ose shërbimin e avionit në trafikun ndërkombëtar të shoqërisë (ve) ajrore të përcaktuar të kësaj Pale tjetër Kontraktuese. Përfshirjet e ofruara nga ky paragraf duhet të aplikohen ndaj rezervave, materialeve, produkteve dhe pajisjeve, të listuara në këtë paragraf:

- kur ato janë paraqitur në territorin e një Pale Kontraktuese nga ose në emër të shoqërisë (ve) ajrore të përcaktuar të Palës tjetër Kontraktuese; ose

- kur janë mbajtur në bord të avionit të shoqërisë(ve) ajrore të përcaktuar të një Pale Kontraktuese gjatë mbërritjes në ose gjatë largimit nga territori i Palës tjetër Kontraktuese; ose

- kur janë marrë në bord të avionit të shoqërisë (ve) ajrore të përcaktuar të një Pale Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese dhe që kanë për qëllim përdorimin në trafikun ndërkombëtar.

2. Përfshirja dhe kushtet e përmendura në paragrafin (1) të këtij neni, gjithashtu, duhet të aplikohen dhe për çështjet e mëposhtme:

- riparimi i avionit, mirëmbajtja dhe pajisjet e shërbimit dhe pjesët përbërëse;
- trajtimi i pasagjerëve dhe pajisjet e ngarkimit të kargos dhe pjesët përbërëse;
- pajisjet e sigurimit, përfshirë pjesët përbërëse;
- materialet e instruksioneve dhe mjetet ndihmëse të trajnimit;
- kompjuter, rezervimi elektronik dhe pajisjet e telekomunikacionit dhe pjesët përbërëse, në sasira të kufizuara, që kanë për qëllim dhe që përdoren vetëm në zyrat e përfaqësimit të shoqërisë(ve) ajrore të përcaktuara;

- dokumentet e shoqërisë ajrore dhe të operatorit, përfshirë stokun e biletave të printuara, faturat ajrore dhe çdo material të shtypur, të cilat mbartin emblemen e kompanisë dhe materiale publiciteti të zakonshme të shpërndara pa detyrime nga shoqëria(të) ajrore e përcaktuar.

3. Përfshirja nga kufizimet e importit, detyrimet doganore, taksat e akcizës kombëtare, tarifat e inspektimit, detyrimet e tjera kombëtare nuk do të aplikohen ndaj detyrimeve që bazohen në koston e shërbimeve të ofruara për shoqëritë ajrore të përcaktuara të një Pale Kontraktuese, në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

4. Pajisjet dhe materialet normale të bordit, si dhe furnizimet dhe rezervat, të referuara në paragrafin (1) të këtij neni, të mbajtura në bord të avionit të një Pale Kontraktuese që kryen shërbimin e miratuar, mund të shkarkohen në territorin e Palës tjetër Kontraktuese vetëm me miratim të autoriteteve doganore të atij territori. Në këtë rast, ato mund të vihen nën supervisionin dhe nën kontrollin e autoriteteve në fjalë deri sa ato të riksportohen ose përpunohen në përputhje me rregullat doganore.

5. Përfshirjet e ofruara nga ky nen duhet të jenë gjithashtu të vlefshme në situata kur shoqëria (të) ajrore e përcaktuar e një Palë Kontraktuese ka hyrë në marrëveshje me shoqërinë ose shoqëri të tjera ajrore për kredi ose transfertë të artikujve të specifikuar në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, duke i siguruar shoqërisë ose shoqërive të tjera ajrore që të gëzojnë në mënyrë të njëjtë këto përjashtime nga kjo Palë tjetër Kontraktuese.

#### Neni 11

#### **Aplikueshmëria e fluturimeve jo të rregullta**

1. Dispozitat e vendosura në nenet: aplikimi i ligjeve dhe rregullave; njohja e certifikatave dhe licencave; sigurimi i aviacionit; “Parashikimet statistikore”; “Përfshirjet nga doganat dhe detyrimet e tjera”: “Kontrolli i emigracionit” dhe “Konsultimet” e kësaj Marrëveshjeje duhet të jenë të aplikueshme, gjithashtu, dhe për fluturimet jo të rregullta që kryhen nga një transportues ajror që kryen fluturime të tilla.

2. Dispozitat e paragrafit (1) të këtij neni nuk duhet të cenojnë ligjet dhe rregullat kombëtare, që qeverisin autorizimin e operimeve të paplanifikuara ose drejtimin e transportuesve ajrorë ose palëve të tjera të përfshira në organizimin e operimeve të tilla.

3. Duhet të ekzistojë mundësia e ndershme dhe e barabartë për transportuesit ajror të të dy

Palëve Kontraktuese për të kryer fluturime jo të rregullta ndërmjet territoreve të tyre.

4. Në operimin e fluturimeve jo të rregullta, operatorët e njëjës Palë Kontraktuese duhet të marrin në konsideratë interesat e shoqërisë(ve) ajrore të përcaktuar të Palës tjetër Kontraktuese për të mos ndikuar padrejtësisht në rezultatet e shoqërive ose shoqërisë që rrjedhin nga operimet e shërbimeve ajrore të rregullta të miratuara në të gjithë ose në një pjesë të të njëjtave rrugë.

5. Kapaciteti që ofrohet për kryerjen e shërbimeve ajrore jo të rregullta, kurdoherë që është e mundur, duhet të vendoset nga marrëveshja e përbashkët ndërmjet operatorëve që i përkasin të dyja Palëve Kontraktuese dhe një marrëveshje e tillë duhet të miratohet nga autoritetet aeronautike të Palëve Kontraktuese.

## Neni 12

### **Parashikimi i statistikave**

Autoritetet aeronautike të njëjës Palë Kontraktuese duhet t'i sigurojnë autoriteteve aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese, sipas kërkesës, të dhëna të tilla periodike ose të dhëna të tjera statistikore, të cilat mund të kërkojnë me të drejtë për qëllim të rishikimit të kapacitetit të ofruar për shërbimet e miratuara nga shoqëritë ajrore të përcaktuara të Palëve Kontraktuese. Këto deklarata duhet të përfshijnë të gjithë informacionin e kërkuar për të përcaktuar volumnin e trafikut të kryer nga shoqëritë ajrore të përcaktuara në shërbimet e miratuara dhe origjinën dhe destinacionin e një trafiku të tillë.

## Neni 13

### **Aplikimi i ligjeve dhe rregullave**

Ligjet, rregullat dhe procedurat e njëjës Palë Kontraktuese në lidhje me pranimin në ose nisjen nga territori i saj të avionit të angazhuar në shërbimet ajrore ndërkombëtare ose për operimin dhe navigimin e një avioni të tillë duhet të përputhen me shoqërinë ajrore të përcaktuar të Palës tjetër Kontraktuese mbi hyrjen e saj në dhe gjatë dhe duke përfshirë nisjen e saj nga territori në fjalë.

Ligjet, rregullat dhe procedurat e njëjës Palë Kontraktuese në lidhje me emigracionin, pasaportën ose dokumente të tjera të aprovuara udhëtimi, hyrjen, kalimin, sigurimin e aviacionit, doganat, pasaportat, monedhat, rregullat sanitare dhe të karantinës duhet të përputhen me ekuipazhet, pasagjerët, kargon dhe postën, të transportuar nga avioni i shoqërisë ajrore të përcaktuar të Palës tjetër Kontraktuese gjatë hyrjes në, gjatë qëndrimit dhe përfshirë nisjen e tyre nga territori i Palës Kontraktuese në fjalë.

Pasagjerët, bagazhet, kargo dhe posta që kalon në tranzit direkt përmes territorit të njëjës Palë Kontraktuese që nuk dalin nga zona e aeroportit, e rezervuar për një qëllim të tillë, duhet të jenë subjekt vetëm i një kontrolli të thjeshtë, me përjashtim të masave të sigurimit kundër dhunës dhe piraterisë ajrore, si dhe kontrabandës së drogave narkotike dhe produkteve pararendëse të tyre. Bagazhet dhe kargo që kalon në tranzit direkt duhet të përjashtohen nga detyrimet doganore dhe taksa të tjera të ngjashme.

Taksat dhe detyrimet e aplikuara në territorin e Palës Kontraktuese mbi shoqërinë(të) ajrore të përcaktuar të Palës tjetër Kontraktuese për shërbimet ajrore të Palës tjetër Kontraktuese nuk duhet të jenë më të larta se ato të aplikuara për operimet e ndonjë shoqërie tjetër ajrore të angazhuar në të njëjtat operime.

Asnjë nga Palët Kontraktuese nuk duhet të favorizojë shoqërinë ose shoqëritë e saj ajrore ose çdo shoqëri tjetër ajrore, kundrejt një shoqërie ose shoqërive ajrore të angazhuara në shërbime ajrore të njëjta ndërkombëtare të Palës tjetër Kontraktuese në aplikimin e doganave të saj, emigracionit, karantinës dhe rregullave të njëjta ose në përdorimin e aeroporteve, rrugëve ajrore, shërbimeve të trafikut ajror dhe mjeteve shoqëruese nën kontrollin e saj.

Mbi bazën e reciprocitetit, vizat nuk duhet të kërkojnë për hyrje, qëndrim dhe dalje të ekuipazhit të avionit që operohet nga shoqëritë ajrore të përcaktuara të Palëve Kontraktuese, nëse ata largohen në të njëjtin fluturim pasardhës në rrugën e kthimit. Kjo i referohet gjithashtu dhe rasteve kur ekuipazhi për arsye teknike, shëndetësore ose mjekësore qëndron në vend dhe largohet në fluturimin tjetër pasardhës në rrugën e kthimit.

Neni 14  
**Kontrolli i emigracionit**

1. Me kërkesë të njëres Palë Kontraktuese, Pala tjetër Kontraktuese duhet të lejojë shoqëritë ajrore të përcaktuara, të cilat ushtrojnë të drejtat e trafikut ajror në të dy vendet, të marrin masa për të siguruar se janë transportuar vetëm pasagjerët me dokumente udhëtimi të kërkuara për hyrje ose tranzit përmes shtetit në fjalë.

2. Asnjëra Palë Kontraktuese nuk duhet të pranojë për shqyrtim një person të kthyer nga pika e tij e zbritjes pasi ai të konstatohet i papranueshëm, në qoftë se ky person para hipjes ka qëndruar në territorin e saj, përveç kalimit tranzit direkt. Palët Kontraktuese nuk duhet të kthejnë një person të tillë në vendin ku ai më parë është konstatuar i papranueshëm.

3. Kjo dispozitë nuk ka për qëllim të parandalojë autoritetet publike për të shqyrtuar më tej një person të papranueshëm të kthyer, për të përcaktuar pranimin e tij të mundshëm në një shtet ose të bëjë rregullimet për transferimin e tij, largimin ose dërgimin në një shtet, shtetas i të cilit është ky person ose ku ai është i pranueshëm. Nëse një person që konstatohet i papranueshëm ka humbur ose shkatërruar dokumentet e tij të udhëtimit, Palët Kontraktuese duhet të pranojnë në vend të tyre një dokument që vërteton situatat e embarkimit dhe mbërritjes, të lëshuar nga autoritetet publike të Palës Kontraktuese ku personi është gjetur i papranueshëm.

Neni 15  
**Njohja e certifikatave dhe e licencave**

1. Certifikatat e vlefshmërisë ajrore, certifikatat e kompetencës dhe licencat të lëshuara ose të bëra të vlefshme nga një Palë Kontraktuese dhe që janë akoma në fuqi do të njihen si të vlefshme nga Pala tjetër Kontraktuese, për qëllim të operimit të shërbimeve të miratuara në rrugët e specifikuara, nëse kërkesat sipas të cilave janë lëshuar ose bërë të vlefshme këto certifikata dhe licenca janë të njëjta ose mbi standardet minimale që mund të vendosen në përputhje me Konventën. Një Palë Kontraktuese, sidoqoftë, rezervon të drejtën e refuzimit të njohjes së vlefshmërisë së certifikatës së kompetencës dhe të licencave të dhëna shtetasve të saj nga Pala tjetër Kontraktuese, për qëllim të mbikalimit mbi territorin e saj.

2. Një Palë Kontraktuese mund të kërkojë konsultime, në përputhje me nenin 18 të kësaj Marrëveshjeje në rast se rregullat dhe praktikat e Palës tjetër Kontraktuese sipas të cilave këto certifikata dhe licenca janë lëshuar ose bërë të vlefshme ndryshojnë në ndonjë aspekt të veçantë nga standardet e vendosura në përputhje me Konventën dhe këto ndryshime janë arkivuar në Organizatën e Aviacionit Civil Ndërkombëtar, në përputhje me nenin 38 të Konventës. Nëse nuk arrihet një marrëveshje e kënaqshme në lidhje me sigurinë e fluturimit, kjo do të përbëjë një bazë për zbatimin e nenit 4 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 16  
**Sigurimi i aviacionit**

1. Palët Kontraktuese bien dakord t'i ofrojnë ndihmë njëra-tjetrës, nëse është e nevojshme, nga pikëpamja e parandalimit të rrëmbimeve të paligjshme të avionit dhe akteve të tjera të paligjshme kundrejt sigurisë së avionit, aeroporteve dhe mjeteve ndihmëse të navigacionit ajror, si dhe të ndonjë kërcënimi tjetër të sigurisë së aviacionit.

2. Çdo Palë Kontraktuese bie dakord të shqyrtojë kushtet e sigurisë jodiskriminuese dhe përgjithësisht të aplikueshme të kërkuara nga Pala tjetër Kontraktuese për hyrjen në territorin e Palës tjetër Kontraktuese dhe të marrë masat e duhura për inspektimin e pasagjerëve, si dhe të artikujve që ata mbartin me vete. Çdo Palë Kontraktuese, gjithashtu, duhet t'i kushtojë vëmendjen e duhur nga çdo kërkesë nga Pala tjetër Kontraktuese për masa sigurie speciale për avionin ose për pasagjerët e tij, të cilët mund të përballen me një kërcënim të veçantë.

3. Pala Kontraktuese duhet të veprojë në përputhje me kushtet e aplikueshme të sigurisë së

aviacionit të vendosura nga Organizata e Aviacionit Ndërkombëtar. Nëse një Palë Kontraktuese devijon nga kushte të tilla, Pala tjetër Kontraktuese mund të kërkojë konsultime me këtë Palë Kontraktuese. Nëse nuk është pranuar ndryshe nga Palët Kontraktuese, këto konsultime duhet të fillojnë brenda një periudhe prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga data e marrjes së një kërkesë të tillë. Nëse nuk arrihet një marrëveshje e pranueshme do të përbëjë bazë për zbatimin e nenit 19 të kësaj Marrëveshjeje.

4. Palët Kontraktuese duhet të veprojnë në përputhje me dispozitat e Konventës për sulmet dhe akte të tjera të kryera në bord të avionit, e nënshkruar në Tokio më 14 shtator 1963; Konventës për ndërhyrjet ndaj akteve të paligjshme të rrëmbimit të avionit, e nënshkruar në Hagë më 16 dhjetor 1970 dhe Konventës për ndërhyrjet ndaj akteve të paligjshme ndaj sigurisë së aviacionit civil, e nënshkruar në Montreal, më 23 shtator 1971, kur këto Palë Kontraktuese janë të dyja Palë të këtyre Konventave.

5. Kur ndodh një incident ose kërcënim i një incidenti të rrëmbimit të paligjshëm të avionit ose akte të tjera të paligjshme kundër sigurisë së avionit, aeroporteve dhe mjeteve ndihmëse të navigacionit ajror, Palët Kontraktuese duhet të ndihmojnë njëra-tjetrën me anë të lehtësimit të komunikimit, me qëllim eliminimin sa më të shpejtë dhe të sigurt të një incidenti ose kërcënimi të tillë.

#### Neni 17

#### **Siguria**

1. Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë konsultime në çdo kohë në lidhje me standardet e sigurisë në çdo zonë në lidhje me ekuipazhin e avionit ose të operimeve të tyre të adaptuara nga Pala tjetër Kontraktuese. Këto konsultime duhet të zhvillohen brenda 30 ditëve nga kjo kërkesë.

2. Nëse pas konsultimeve të tilla një Palë Kontraktuese vëren se Pala tjetër Kontraktuese nuk ka mirëmbajtur dhe administruar efektivisht standardet e sigurisë në një zonë të tillë, të cilat janë të paktën të barabarta me standardet minimale të vendosura në këtë kohë në përputhje me Konventën e Çikagos, Pala e parë Kontraktuese duhet të njoftojë Palën tjetër Kontraktuese për këto vërejtje dhe masat të konsiderohen të nevojshme për të respektuar këto standarde minimale dhe Pala tjetër Kontraktuese të ndërmarrë masat përkatëse brenda 15 ditëve ose një periudhë më të gjatë, siç është rënë dakord, do të jetë bazë për zbatimin e nenit 4 të kësaj Marrëveshjeje.

3. Megjithatë detyrimet e përmendura në nenin 33 të Konventës së Çikagos, është rënë dakord që çdo avion që operon për një shoqëri ose shoqëri të tjera ajrore të përcaktuara të Palës Kontraktuese, në shërbimet për në ose nga territori i një Pale tjetër Kontraktuese, mund të jetë subjekt i ekzaminimit nga përfaqësuesit e autorizuar të Palës tjetër Kontraktuese në bord dhe rreth avionit për të kontrolluar vlefshmërinë e dokumenteve të avionit, si dhe ato të ekuipazhit, të kushteve të avionit dhe të pajisjeve të tij, ndërkohë që është në territorin e Palës tjetër Kontraktuese (në këtë nen ato emërtohen “inspektim ramp”), duke siguruar që ato nuk do të çojnë në vonesa të paarsyeshme.

4. Nëse një inspektim ramp ose seri inspektimesh ramp ngre:

- shqetësime serioze që një avion ose operimi i një avioni nuk është në përputhje me standardet minimale të vendosura në atë kohë në përputhje me Konventën e Çikagos; ose

- shqetësime serioze që ka mungesë të mirëmbajtjes dhe administrimit efektiv të standardeve të sigurisë të vendosura në atë kohë në përputhje me Konventën e Çikagos, Pala Kontraktuese që kryen inspektimin, për qëllimet e nenit 33 të Konventës së Çikagos, është e lirë të konkludojë që kërkesat sipas të cilave janë dhënë certifikata ose licencat, në lidhje me kërkesat sipas të cilave operon avioni, nuk janë të barabarta me ose mbi standardet minimale të vendosura në përputhje me Konventën e Çikagos.

5. Në rast të hyrjes për qëllim të ndërmarrjes së një inspektimi ramp të një avioni që operohet nga një ose disa shoqëri të tjera ajrore të përcaktuara të një Pale Kontraktuese, në përputhje me paragrafin 3 të mësipërm, refuzohet nga përfaqësuesi i kësaj shoqërie ose shoqërive ajrore, Pala tjetër Kontraktuese është e lirë të informojë për këto shqetësime serioze të tipit referuar në paragrafin (4) më sipër, të ngrejë dhe të nxjerrë konkluzionet e referuara në këtë paragraf.

6. Çdo Palë Kontraktuese rezervon të drejtën të pezullojë ose të ndryshojë menjëherë

autorizimin e operimit të një shoqërie ose shoqërive të tjera ajrore të përcaktuar të Palës tjetër Kontraktuese, nëse Pala e parë Kontraktuese konkludon që si rezultat i inspektimit ramp, refuzimit për kryerjen e inspektimit ramp, konsultimit ose ndonjë veprimi tjetër është e nevojshme të merren masa të menjëhershme për sigurinë e operimit të një shoqërie ajrore.

Çdo veprim nga një Palë Kontraktuese, në përputhje me paragrafët (2) ose (6) më sipër, do të ndërpritet nëse bazat për ndërmarrjen e një veprimi të tillë nuk ekzistojnë më.

#### Neni 18

##### **Konsultime dhe amendamente**

1. Në kuadrin e bashkëpunimit të ngushtë, autoritetet aeronautike të të dyja Palëve Kontraktuese duhet të konsultohen me njëra-tjetrën në mënyrë periodike, me qëllim që të sigurohet zbatimi i duhur i kësaj Marrëveshjeje dhe anekseve të saj.

2. Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë konsultime në çdo kohë mbi interpretimin, aplikimin ose amendimin e kësaj Marrëveshjeje. Këto konsultime të cilat mund të mbahen nga autoritetet aeronautike ose me anë të korrespondencës, ose me anë të bisedimeve duhet të fillojnë brenda një periudhe prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga data që Pala tjetër Kontraktuese merr kërkesën me shkrim, nëse nuk është rënë dakord ndryshe nga Palët Kontraktuese.

Këto konsultime mund të kryhen me anë të diskutimeve ose me anë të korrespondencës.

3. Çdo amendament ose modifikim i aneksit mund të pranohet direkt midis autoriteteve aeronautike të të dy Palëve Kontraktuese dhe do të hyjë në fuqi në një datë të përcaktuar bashkërisht nga autoritetet në fjalë.

4. Në rast të përfundimit të ndonjë konvente të përgjithshme multilaterale në lidhje me transportin ajror ku përfshihen të dy Palët Kontraktuese, pjesa e kësaj Marrëveshjeje që është në kundërshtim me këtë Konventë duhet të modifikohet që të jetë në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

#### Neni 19

##### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje ndërmjet Palëve Kontraktuese në lidhje me interpretimin ose aplikimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese në radhë të parë duhet t'i zgjidhin ato me anë të bisedimeve midis tyre.

2. Nëse Palët Kontraktuese dështojnë në arritjen e një Marrëveshjeje me anë të bisedimeve, mosmarrëveshja me kërkesë të njëres Palë Kontraktuese mund t'i referohet për vendim një gjykate me tre arbitra, njëri të jetë i zgjedhur nga secila Palë Kontraktuese dhe i treti të vendoset nga dy arbitrat e zgjedhur, duke siguruar që arbitri i tretë të mos jetë shtetas i ndonjëres Palë Kontraktuese. Çdo Palë Kontraktuese duhet të caktojë një arbitër brenda një periudhe 60 (gjashtëdhjetë) ditore nga data që njëra Palë Kontraktuese merr nga Pala tjetër Kontraktuese një notë diplomatike që kërkon arbitrimin e mosmarrëveshjes dhe arbitri i tretë duhet të pranohet brenda një periudhe të mëtejshme prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh. Nëse njëra nga Palët Kontraktuese nuk arrin të caktojë arbitrin e saj brenda një periudhe prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh ose nëse arbitri i tretë nuk përcaktohet brenda periudhës së përcaktuar, Presidentit të Këshillit të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil mund t'i kërkohet nga njëra Palë Kontraktuese të caktojë një arbitër ose arbitrat.

3. Palët Kontraktuese angazhohen të zbatojnë çdo vendim të marrë sipas paragrafit (2) të këtij neni.

4. Çdo Palë Kontraktuese duhet të mbulojë shpenzimet dhe pagesat e nevojshme për arbitrin e saj; pagesa për arbitrin e tretë dhe shpenzimet e nevojshme për këtë, ashtu si dhe për aktivitetin e këtij arbitrimi duhet të ndahen në mënyrë të barbartë nga Palët Kontraktuese.

#### Neni 20

##### **Denoncimi**

Çdo Palë Kontraktuese në çdo kohë mund t'i njoftojë me shkrim Palës tjetër Kontraktuese

vendimin e saj për të denoncuar këtë Marrëveshje. Një njoftim i tillë, duhet të dërgohet njëkohësisht në Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil. Në këtë rast, Marrëveshja duhet të përfundojë 12 (dymbëdhjetë) muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga Pala tjetër Kontraktuese, në qoftë se njoftimi nuk tërhiqet me një marrëveshje të përbashkët para mbarimit të kësaj periudhe.

Në mungesë të konfirmimit të marrjes së njoftimit nga Pala tjetër Kontraktuese, njoftimi do të gjykohet se është marrë 14 (katërmëdhjetë) ditë pas marrjes së njoftimit nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil.

#### **Neni 21 Rregjistrimi**

Kjo Marrëveshje dhe të gjitha amendamentet e saj duhet të regjistrohen pranë Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil dhe pranë Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara.

#### **Neni 22 Aplikimi i Marrëveshjes shumëpalëshe**

Nëse një marrëveshje shumëpalëshe lidhur me ndonjë çështje të mbuluar nga kjo Marrëveshje dhe të pranuar nga të dyja Palët Kontraktuese, hyn në fuqi, dispozitat përkatëse të kësaj Marrëveshjeje shumëpalëshe do të zëvendësojnë dispozitat përkatëse të kësaj Marrëveshjeje.

#### **Neni 23 Hyrja në fuqi**

Kjo Marrëveshje nënshkruhet për një periudhë kohore të papërcaktuar dhe do të hyjë në fuqi datën e marrjes së notës së dytë diplomatike të shkëmbyer nga të dy Palët Kontraktuese, që konfirmon që kërkesat e brendshme dhe/ose konstitucionale respektive të tyre për hyrjen në fuqi të marrëveshjeve ndërkombëtare janë plotësuar.

Pas hyrjes në fuqi, kjo Marrëveshje shfuqizon efektin e Marrëveshjes dypalëshe të shërbimeve ajrore ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Bullgarisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë të nënshkruar më 13 mars 1990, në Sofje.

Në dëshmi të nënshkruesve, të autorizuar plotësisht nga qeveritë e tyre respektive, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në dy kopje, në Sofje, më 21 mars 2002, në gjuhët bullgarisht, shqip dhe anglisht, të gjitha tekstet kanë autoritet të barabartë. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në lidhje me interpretimin ose zbatimin, teksti anglisht do të mbizotërojë.

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË  
BULLGARISË

ANEKS

#### **PËR MARRËVESHJEN E SHËRBIMEVE AJRORE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË BULLGARISË**

Grafiku i linjave të rregullta

1. Shoqëria ajrore e përcaktuar e Republikës së Bullgarisë do të lejohet të kryejë shërbimet ajrore mbi rrugët specifike si më poshtë:

- pikat në Bullgari – pikat e ndërmjetme – Tiranë
- pikat e përtejme dhe anasjelltas.

2. Shoqëria ajrore e përcaktuar e Republikës së Shqipërisë do të lejohet të kryejë shërbimet ajrore mbi rrugët specifike si më poshtë:

- pikat në Shqipëri – pikat e ndërmjetme – Sofja
- pikat e përtejme dhe anasjelltas.

Shënime:

1. Ndonjë ose të gjitha pikat e ndërmjetme dhe/ose pikat e përtejme mbi secilën nga rrugët e specifikuar, me dëshirën e çdo shoqërie ajrore të përcaktuar, mund të hiqen në ndonjë fluturim ose në të gjitha fluturimet, me kusht që këto fluturime të nisin dhe të përfundojnë respektivisht në territorin e Palës Kontraktuese që ka përcaktuar shoqërinë ajrore.

2. Shoqëritë ajrore të përcaktuara të Palëve Kontraktuese duhet të lejohen të kryejnë fluturime mbi rrugët e përmendura më sipër, pa kufizime të frekuencës dhe tipit të avionit, në çdo konfiguracion.

3. E drejta e 5-të e trafikut të lirisë, për dhe nga një vend i tretë, duhet të jetë e vlefshme në shërbimet e miratuara, duke siguruar që ato janë koordinuar dhe pranuar më parë ndërmjet shoqërive ajrore të përcaktuara dhe të miratuara nga autoritetet aeronautike përkatëse.

4. Të gjitha ose ndonjë nga pikat e ndërmjetme dhe/ose pikat e përtejme, me dëshirën e shoqërive ajrore, mund të hiqen nga të gjitha fluturimet ose nga ndonjë fluturim, me kusht që shërbimi të fillojë ose të mbarojë në territorin e Palës Kontraktuese që ka përcaktuar shoqërinë (të) ajrore.

**Fletorja Zyrtare gjendet:**

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:  
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

- Kodin Penal (të azhurnuar);
- Kodin e Procedurës Penale (të azhurnuar);
- Kodin Civil (të azhurnuar);
- Përmbledhjen e legjislacionit në fushën e transporteve (Kodin Rrugor dhe ligjin për transportet, e azhurnuar);
- Kodin Zgjedhor (të azhurnuar);
- Kodin Doganor (Dispozitat zbatuese të Kodit Doganor).

|                                                                                              |                                                                                                                   |                                                                                                                  |                                                                                                  |
|----------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Kodi Penal</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Mars, 2002 | <b>Kodi i<br/>Procedurës Penale</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Shtator, 2002 | <b>Kodi i<br/>Procedurës Civile</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Korrik, 2002 | <b>Kodi Rrugor</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Qershor, 2002 |
|----------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------|

U dorëzua për shtyp më 16. 10. 2002  
Doli nga shtypi më 17. 10. 2002

Tirazhi: 4250 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë

